



VENDIM

Nr. 4, Datë 27.01.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
LICENSËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “dh”; 38 dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për miratimin e licensës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike dhe draftin përkatës,

Konstatoi se:

- Operatori i Tregut është subjekt i cili në përmbushje të kushteve përkatëse, pajiset me licensë në ERE, siç parashikohet në nenin 57, pika 1 të ligjit në fuqi.
- ERE është organi përgjegjës për dhënien e licensës së Operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (neni 37 pika 2 gërma “dh”).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e licensës e licensës së për veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë elektrike,
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.